

BILANCI I PAGESAVE¹

Përmbajtja

Llogaria korrente	2
Tregtia e mallrave	3
Tregtia e shërbimeve	3
Të ardhurat parësore	4
Të ardhurat dytësore	5
Llogaria kapitale	5
Llogaria financiare	5

Kryesore:

Në tremujorin e dytë 2019:

- Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 273 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë;
- Llogaria e shërbimeve vlerësohet në një balancë pozitive prej rreth 263 milionë euro, në rritje në terma vjetorë;
- Fluksi i investimeve të huaja direkte, vlerësohet në 248 milionë euro;
- Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 186 milionë euro;
- Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 6.6 muaj imperte në mallra dhe shërbime.

Në tremujorin e dytë të vitit 2019, *deficiti i llogarisë korrente* vlerësohet në rreth 273 milionë euro. Në terma vjetorë, deficiti korrent u zgjerua me rreth 62%.

Thellimi i deficitit korrent në masën më të madhe është diktuar nga zgjerimi i *deficitit tregtar* në mallra—në reflektim të rritjes së shpenzimeve për importe dhe rënies së të ardhurave nga eksportet. Në të njëjtën kohë, zgjerimi i balancës negative të të ardhurave (*parësore*) nga investimet ka qenë faktor shtesë në thellimin e deficitit korrent.


Deficiti tregtar (mallra dhe shërbime) u zgjerua me rreth 21%, në nivelin 519 milionë euro.

Fluksi hyrës neto në *llogarinë financiare* prej 307 milionë euro, në zgjerim me rreth 8% në terma vjetore, mbulon plotësisht deficitin korrent. Flukset hyrëse neto në llogarinë financiare reflektojnë zgjerimin e detyrimeve neto në formën e investimeve direkte, si dhe tkurrjen e zotërimeve jashtë të ekonomisë shqiptare - kryesisht zotërimet e sektorit bankar në tituj borxhi.

Gjatë periudhës, mjetet e rezervës ranë me rreth 44 milionë euro në nivelin 3,297 milionë euro, i mjaftueshëm për mbulimin e 6.6 muaj imperte të mallrave dhe shërbimeve.

Në terma vjetorë, transaksionet financiare gjatë periudhës, rezultuan në zgjerim të *detyrimit financiar* të Shqipërisë me botën me rreth 8%.

*Shkalla e ekspozimit*² të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 261 milionë euro, në zgjerim me rreth 114 milionë euro referuar nivelit në një vit më parë.



Grafik 1. Llogaria korrente dhe flukset financiare neto (*shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve*). Shënim: Flukset financiare neto paraqiten sipas parimit të drejtimit të investimit.

1. Të dhënat janë hartuar bazuar në metodologjinë e FMN "Manuali i Bilancit të Pagesave, Botimi i 6-të". Bilanci i Pagesave (BP) regjistron të gjitha transaksionet ekonomike të ndodhura midis njëjësive rezidente dhe jorezidente, gjatë një periudhe të dhënë kohe.

2. Bilanci i llogarisë korrente së bashku me bilancin e llogarisë kapitale përcakton shkallën e ekspozimit të ekonomisë shqiptare me pjesën tjetër të botës, ndërsa llogaria financiare shpjegon si është financiar ky ekspozim.

LLOGARIA KORRENTE

Gjatë periudhës, vëllimi i *transaksioneve korrente* shënon 3,203 milionë euro, në rritje me rreth 7% në terma vjetorë. Deficiti i *llogarisë korrente* vlerësohet në 273 milionë euro, rreth 62% më i lartë krahasuar me një vit më parë.

Thellimi i *deficitit korrent*, reflekton zgjerimin e deficitit tregtar në mallra dhe balancës negative të të ardhurave parësore nga investimet.

Deficiti tregtar në mallra u thellua me rreth 14% në terma vjetorë, si pasojë së bashku e rritjes së shpenzimeve në importe dhe rënies së të ardhurave nga eksporti i mallrave. Gjatë periudhës, zgjerimin më të madh e patën importet në energji elektrike dhe artikuj tekstilë. Nga ana tjetër, rënia e eksportit u diktua kryesisht nga rënia e të ardhurave nga eksportet në energji elektrike dhe metale bazë.

Ndërkohë, suficiti i *tregtisë në shërbime* u zgjerua lehtësisht me 2%. Pavarësisht dinamikës në tregtinë e shërbimeve, transaksionet e ekonomisë shqiptare me jorezidentët vijojnë të përfaqësohen me kategoritë e shërbimeve *udhëtime, shërbime për përpunim të inpueteve fizike dhe shërbime të tjera*.

Deficiti tregtar në mallra dhe shërbime u zgjerua me rreth 21% në terma vjetorë, në nivelin 519 milionë euro.

Gjatë periudhës, rreth 91% e shpenzimeve korrente³ kanë shkuar për financimin e importeve të mallrave dhe shërbimeve, ndërkohë që hyrjet valutore⁴ janë siguruar kryesisht nga eksportet e shërbimeve (në masën 56%) dhe ato të mallrave dhe të ardhurat dytësore (së bashku për rreth 35%).

Thellimi i deficitit korrent u ndikua kryesisht nga (i) thellimi i deficitit tregtar (në mallra); (ii) balancës negative të të ardhurave parësore.

	Të dhëna kumulative (4-mujore) për fundin e periudhës						T2 2018	T2 2019
	T2 2018			T2 2019				
	Bilanci	Kredi	Debi	Bilanci	Kredi	Debi	Bilanci	Bilanci
Llogaria korrente	- 800	5,256	6,056	- 1,031	5,559	6,591	- 169	- 273
<i>në përqindje ndaj PBB</i>	-6%	42%	48%	-8%	41%	49%		
Mallra	- 2,841	895	3,736	- 3,048	942	3,990	- 684	- 782
Shërbime	1,111	2,956	1,845	1,151	3,195	2,044	257	263
Shërbime për përpunim të inpueteve fizike të zotëruara nga të tjerët	386	388	2	433	435	2	93	96
Transport	37	241	204	18	240	222	14	0
Udhëtime	452	1,770	1,319	427	1,926	1,500	84	81
Shërbime telekomunikacioni, kompjuteri dhe informacioni	10	71	61	21	97	77	4	15
Shërbime të tjera biznesi	328	397	69	326	401	75	75	80
Shërbime dhe mallra qeveritare	- 80	37	116	- 27	49	76	- 10	- 2
Shërbime të tjera	- 21	52	74	- 47	46	93	- 2	- 7
Të ardhura parësore	23	399	376	- 45	410	455	20	- 3
Të ardhura nga puna	276	296	20	288	317	30	97	97
Të ardhura nga investimet	- 253	99	353	- 334	89	423	- 77	- 100
Investime direkte	- 247	25	272	- 310	18	328	- 81	- 104
Investime portofoli	2	21	19	5	24	18	6	5
Investime të tjera	- 37	24	62	- 59	18	77	- 9	- 11
Mjetet e rezervës	30	30		30	30		7	9
Të ardhura të tjera parësore	1	4	3	1	4	3	0	0
Të ardhura dytësore	907	1,006	99	911	1,012	101	239	249
Të ardhura nga emigrantët	668	669	1	675	676	1	182	185

Tabela. Ecuria e përbërësve të bilancit të pagesave (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)

³ Shpenzimet korrente përfshijnë importin e mallrave, importin e shërbimeve, daljet në të ardhurat parësore dhe daljet në të ardhurat dytësore.

⁴ Hyrjet valutore përfshijnë eksportin e mallrave, eksportin e shërbimeve, hyrjet në të ardhurat parësore dhe hyrjet në të ardhurat dytësore.




TREGTIA E MALLRAVE

Vëllimi i përgjithshëm i shkëmbimeve tregtare në mallra u zgjerua me 2% në nivelin 1,266 milionë euro dhe përbën 40% të transaksioneve korrente.

Në terma vjetore, *eksporti i mallrave* ra me 13% në nivelin 242 milionë euro. *Importi i mallrave* shënon 1,024 milionë euro dhe në terma vjetorë është rritur 6%.

Thellimi i *deficitit tregtar në mallra* (+14%), këtë tremujor reflekton kryesisht rritjen e importeve në energji elektrike, dhe në të njëjtën kohë rënien e eksporteve në energji elektrike dhe në metale bazë.

Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet vlerësohet në nivelin 24%, ose 5 pikë përqindje më pak se një vit më parë.



Grafik 2. Ecuria e tregtisë në mallra (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Thellimi i deficitit të tregtisë në mallra është kryesisht pasojë e importeve të larta të produkteve minerare dhe njëkohësisht rënies së eksporteve të tyre.

TREGTIA E SHËRBIMEVE

Tregtia në shërbime, gjatë periudhës, u mbyll me një balancë pozitive prej 263 milionë euro, me rritje të lehtë në terma vjetorë, prej 2% .

Transaksionet e ekonomisë shqiptare në shërbime me jorezidentët vijojnë të përfaqësohen me kategoritë e shërbimeve *udhëtime, shërbime për përpunim të inpueteve fizike dhe shërbime të tjera*.

Shërbimet e udhëtimit u mbyllën me bilanc pozitiv prej 81 milionë euro, lehtësisht në rënie me 2% në terma vjetorë. Sëbashku, të ardhurat dhe shpenzimet në këtë kategori janë zgjeruar me respektivisht me 12% dhe 15%. Shërbimet e udhëtimit zënë peshën më të madhe në flukset hyrëse dhe dalëse të regjistruara nën llogarinë e shërbimeve – me 62% të të ardhurave dhe 77% të shpenzimeve të saj.

Gjatë tremujorit të dytë 2019, eksporti i shërbimeve të udhëtimit i ka siguruar ekonomisë vendase rreth 506 milionë euro. Rritja vjetore e të ardhurave u ndikua nga rritja e numrit të vizitorëve të huaj (jorezidentë) me 14%.



Nga ana tjetër, udhëtarët rezidentë (shqiptarë dhe të huaj) kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë vendit 425 milionë euro. Në baza vjetore, numri i rezidentëve që kanë udhëtuar jashtë është rritur me 8%.

Bilanci pozitiv i “shërbimeve për përpunim të inputeve fizike⁵ të zotëruara nga të tjerët” u vlerësua në 96 milionë euro. Të ardhurat hyrëse të kësaj kategorie u zgjeruan lehtësisht në terma vjetorë me rreth 3% në nivelin 96 milionë euro dhe përfaqësojnë shërbime që ekonomia shqiptare i ofron partnerëve të huaj (jorezidentëve) për përpunimin e mallrave të zotëruara prej këtyre të fundit.

“Shërbime të tjera biznesi” rezultuan me bilanc pozitiv prej 80 milionë euro, në rritje vjetore prej 7%. Kjo kategori shërbimi i ka sjellë ekonomisë shqiptare rreth 99 milionë euro flukse valutore hyrëse.

Gjithashtu, gjatë periudhës bilanci në shërbime u ndikua pozitivisht nga zgjerimi i suficitit në *“shërbime telekomunikacioni, kompjuteri dhe informacioni”*.


Shërbimet e udhëtimit kryesojnë në fluksin hyrës dhe dalës të llogarisë së shërbimeve – me 62% të të ardhurave dhe 77% të shpenzimeve të saj.

TË ARDHURAT PARËSORE

Llogaria e të ardhurave parësore (puna dhe kapitali) u mbyll me fluks neto negativ prej 3 milionë eurosh. Në terma vjetorë, fluksin hyrës dhe ato dalës u rritën respektivisht me 7% dhe 30%.

Të ardhurat neto faktoriale nga puna, të cilat kryesojnë fluksin hyrës të të ardhurave parësore, vlerësohen në 97 milionë euro, në të njëjtin nivel të një viti më parë.

Të ardhurat nga investimet kanë thelluar bilancin negativ (flukse neto dalës), rreth 30% në terma vjetorë, në nivelin 100 milionë euro. Fluksi dalës prezantohet në formën e pagesave të dividendëve dhe fitimit të rinvestuar (109 milionë euro) si dhe pagesa interesash (17 milionë euro).



Grafik 3. Ecuria e të ardhurave parësore nga investimet (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).


⁵ Këtu përfshihet vëllimi i transaksioneve të kryera për industrinë e tekstileve dhe të artikujve tekstile, dhe të këpucëve (industria e përpunimit me lëndë të parë të huaj në vend).



TË ARDHURAT DYTËSORE

Të ardhurat dytësore u vlerësuan në 249 milionë euro, në rritje vjetore prej 4%. Ecuria reflekton kryesisht rritjen e transfertave korrente drejt sektorit privat.

Rreth 74% e të ardhurave dytësore përfaqësohet nga transfertat neto të “të ardhura nga emigrantët”. Prurjet valutore të emigrantëve, gjatë këtij tremujori, vlerësohen në rreth 186 milionë euro, me rritje vjetore prej 2%.



Grafik 4. Ecuria e të ardhurave dytësore dhe të ardhurat nga emigrantët (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 186 milionë euro.

LLOGARIA KAPITALE

Llogaria kapitale regjistroi fluks neto pozitiv, në nivelin 12 milionë euro. Në terma vjetorë ky nivel vlerësohet rreth 42% më i ulët, dhe është ndikuar sëbashku, nga zgjerimi i fluksit dalës së transfertave kapitale të sektorit privat dhe rënia në formën e granteve drejt sektorit të qeverisë së përgjithshme.

LLOGARIA FINANCIARE

Transaksionet financiare gjatë periudhës, rezultuan në një fluks hyrës ose zgjerim të *detyrimit financiar* të Shqipërisë me botën me rreth 307 milionë euro, nivel ky rreth 8% më i lartë referuar nivelin në të njëjtën periudhë një vit më parë.

Ky zhvillim pasqyron në masën më të madhe hyrjet në formën e *investimeve direkte* në ekonominë shqiptare. Flukset jo borxh krijuese, në trajtën e *investimeve direkte* u rritën në terma vjetorë me 19%.

Në të njëjtën kohë, zotërimet tona jashtë - mjetet financiare në formën e *investimeve direkte* shqiptare jashtë, u zgjeruan me 22 milionë euro.




Injektimi me kapital të huaj ka shënuar 268 milionë euro, të përqëndruar në sektorin e energjitikës, hidrokarbureve dhe të ndërmjetësimit financiar; marrëdhëniet e borxhit mes kompanive të lidhura derivuan një fluks negativ prej 20 milionë euro.




Fluksi i investimeve të huaja direkte në formën e zgjerimit të kapitalit, vlerësohet në 268 milionë euro – të përqëndruara kryesisht në sektorin e energjitikës (në masën 27%), të hidrokarbureve (në masën 18%) dhe ndërmjetësimit financiar (në masën 14%).

Marrëdhëniet e borxhit mes kompanive të lidhura derivuan një fluks negativ prej 20 milionë euro, si pasojë e shlyerjes së detyrimeve.



Grafik 5. Llogaria financiare dhe fluksneto sipas kategorive përbërëse.




Grafik 6. Ecuria e fluksit të investimeve direkte - mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)

Lëvizjet në investimet e portofolit rezultuan në fluks neto hyrës, prej 82 milionë euro kundrejt zgjerimit në dalje prej 108 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjatë periudhës, zotërimet e sektorit të korporatave depozituese (bankat) në formën e letrave të borxhit ranë me rreth 94 milionë euro.

Efekti neutral i investimeve të tjera në llogarinë financiare këtë tremujor – balanca në nivelin +1 milionë, ka ardhur si pasojë e rënies së mjeteve në të njëjtën masë me tkurrjen e detyrimeve. Mjetet shënuan zgjerim në instrumentat “monedha e depozita” të investuara nga sektori bankar (62 milionë euro) dhe njëkohësisht tkurrje të investimeve në “hua” (-72 milionë euro). Në të njëjtën kohë, ka rënë investimi në “kredi tregtare dhe paradhënie” të sektorit privat (-20 milionë euro).

Tkurrja e detyrimeve, ka ardhur si pasojë e shlyerjes së detyrimeve të “huave” të sektorit të qeverisë së përgjithshme (-32 milionë euro).



Grafik 7. Ecuria e fluksit të investimeve të portofolit dhe investimeve të tjera – mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Mjetet e rezervës ranë me 44 milionë euro. Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës shënon 3,297 milionë euro i mjaftueshëm për mbulimin e 6.6 muaj importesh mesatare në mallra dhe shërbime.

Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 6.6 muaj importe në mallra dhe shërbime.



**DEPARTAMENTI I
STATISTIKAVE
FINANCIARE**

Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë

Tel: + 355 4 241 93 01
+ 355 4 241 93 02
+ 355 4 241 93 03
+ 355 4 241 94 09
+ 355 4 241 94 10
+ 355 4 241 94 11

Fax: + 355 4 241 94 08
Email: statistics@bankofalbania.org



Shënime:

Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në rastin e rishikimeve që sjellin ndryshime të treguesve, Banka e Shqipërisë njihet përdoruesit me faktorët e rishikimit dhe ndikimin përkatës.

Gjatë periudhës kanë ndodhur ndryshime në bilancin e pagesave si pasojë e rishikimeve.

Treguesit e rishikuar janë kryesisht deficitit korrent, të ardhurat parësore, llogaria financiare, investimet direkte, si pasojë e plotësimit të informacionit me të dhëna nga njësitë raportuese.

Është rishikuar seria kohore T1/2018– T1/2019, bazuar në politikën e rishikimit të Bankës së Shqipërisë.

Për më shumë informacion mbi të dhënat e bilancit të pagesave referojuni linkut të mëposhtëm:

https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/Bilanci_i_Pagesave/Te_dhenat_kryesore_per_Bilancin_e_Pagesave.html